



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance



PLANI NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2018-2020

ZYRA E KRYEMINISTRIT / ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË

Ky dokument paraqet vazhdimësinë e veprimeve dhe politikave në nivel vendi për zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023.

Publikuar më 2018



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

PLANI NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSITË KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2018-2020

ZYRA E KRYEMINISTRIT /ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË

*Ky dokument paraqet vazhdimësinë e veprimeve dhe politikave në nivel
vendi për zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave
me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023*

Publikuar më 2018

Falënderimi

Për hartimin e Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 ka qenë e domosdoshme puna e përbashkët e institucioneve dhe vetë personave me aftësi të kufizuara, të cilët me kontributin e tyre kanë mundësuar që ky dokument të paraqet të gjitha veprimet dhe prioritetet, për tri vitet në vazhdim, për përmirësimin e jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara në vend.

Si rrjedhojë në emër të Zyrës së Kryeministrit/Zyrës për Qeverisje të Mirë, e cila ka qenë e mandatuar të koordinojë këtë proces, falënderojmë të gjithë akterët për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë në hartimin e këtij dokumenti qeveritar, duke përfshirë ministrinë e linjës, shoqatat për personat me aftësi të kufizuara dhe partnerët ndërkombëtar.

PËRMBAJTJA

AKRONIMET DHE SHKURTESAT.....	6
HYRJA.....	7
ANALIZA E TË ARRITURAVE TË PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2013-2015.....	8
QËLLIMI I PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2017-2019.....	13
MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	14
SHËNDETËSIA.....	15
Objektiva Strategjike 1 : Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.....	15
Objektiva specifike 1: Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.....	15
Objektiva Specifike 2: Zbulimi i hershëm dhe identifikimi i aftësisë së kufizuar prej kohës paranatale, natale dhe postnatale.....	16
Objektivi Specifik 3: Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK.....	16
MIRËQENIA SOCIALE DHE PUNËSIMI.....	17
Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.....	17
Objektivi specifik 1: Shtrirja e shërbimeve në komunitet.....	17
Objektivi specifik 2 : Krijimi i kushteve të barabarta për Punësimin e PAK.....	19
Objektivi specifike 3: Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin Personave me Aftësi të Kufizuara.....	19
ARSIMI.....	20
Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara.....	20
Objektivi 1: Krijimi i mekanizmeve për identifikimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara.....	20
Objektivi 2: Krijimi, fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të mekanizmeve ndër-sektorial dhe mekanizmeve tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse.....	21
Objektivi 3: Të krijohet një mjedis ipërshtatshëm për gjithëpërfshirje në shkollë dhe komunitet.....	22
Objektivi 4: Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar.....	22
Objektivi 5: Rritja e përfshirjes së nxënësve me NVA në arsimin e mesëm të lartë me fokus në AAP dhe arsim jo formal.....	23

MBROJTJA LIGJORE.....	24
Objektiva Strategjike 4: Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.....	24
<i>Objektiva specifike 1: Hartimi i ligjeve në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara</i>	<i>24</i>
<i>Objektiva specifike 2: Ndryshimi dhe plotësimi i kornizës aktuale ligjore për PAK</i>	<i>24</i>
<i>Objektivi specifik 3: Ngritja e kapaciteteve të stafit profesional në sistemin e drejtësisë për të drejtat e PAK</i>	<i>25</i>
QASJE, INFORMIM, KOMUNIKIM, PJESËMARRJE DHE STATISTIKA.....	26
Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesmarrje si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara.....	26
<i>Objektiva specifike 1: Hulimtimi sipas nevojës i gjendjes në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK</i>	<i>26</i>
<i>Objektiva specifike 2: Sigurimi i qasjes në objekte për PAK</i>	<i>26</i>
<i>Objektivi specifik 3: Sigurimi i qasjes në informacion dhe Transport publik</i>	<i>27</i>
<i>Objektiva specifike 4: Krijimi i mundësive për përfshirjen e PAK në jetën kulturore dhe bujqësore</i>	<i>28</i>

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ASK	- Agjencioni i Statistikave të Kosovës
DKA	- Departamenti Komunal i Arsimit
DMS	- Departamenti i Mirëqenies Familjare
MASHT	- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPB	- Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	- Ministria e Punëve të Jashtme
MKRS	- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
MI	- Ministria e Infrastrukturës
MTI	- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
MZHR	- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MBZHR	- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MAP	- Ministria e Administratës Publike
MAPL	- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MD	- Ministria e Drejtësisë
MF	- Ministria e Financave
PKVPAK	- Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011
PAK	- Personat me Aftësi të Kufizuara
PIA	- Plani individual i edukimit
KDPAK	- Konventa për të Drejta e Personave me Aftësi të Kufizuara, Kombet e Bashkuara
KE	- Komisioni Evropian
OJQ	- Organizata Joqeveritare
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
OPAK	- Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara
QZHMF	- Qendra e Zhvillimit të Mjeksisë Familjare
DUDNJ	- Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut
QB	- Qendra Burimore
ZKM/ZQM	- Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë

HYRJA

Parimi i të drejtave të barabarta do të thotë se nevojat e secilit dhe çdo individ janë të një rëndësie të njëjtë, se ato nevoja duhet të jenë baza e planifikimit të shoqërisë dhe se të gjitha burimet duhet të përdoren në mënyrë të tillë që t'i garantojnë çdo individ mundësi të barabarta për pjesëmarrje e në veçanti Personave me Aftësi të Kufizuara.

Fillimisht, me Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe një vizion të qartë për përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara për një dekadë.

Detyrimet që vazhdojnë të rrjedhin nga ky dokument kanë për fokus pesë fusha kryesore të jetës së qytetarëve me aftësi të kufizuara: shëndetësi, mirëqenie sociale dhe punësim, arsim, mbrojtje ligjore dhe qasje. Përpyekjet e institucioneve dhe të vetë shoqërisë që nga miratimi i këtij dokumenti kanë rezultuar me suksese që kanë ngritur cilësinë e jetës së këtij komuniteti.

Miratimi i Ligjit për Personat e Verbër, Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, si dhe zbatimi i Rregullores së QRK për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në institucione publike për personat e shurdhër kanë qenë disa nga veprimet që janë përmbushur dhe që kanë arritur të ndikojnë drejtpërdrejt në standardin dhe kushtet e jetesës së përfituesve të kësaj kornize ligjore.

Gjithsesi me gjithë situatën e vështirë e cila akoma nuk është në nivelin e dëshirueshëm dhe sfidat financiare që na kanë përcjell gjatë këtyre viteve është e rëndësishme që të vazhdojmë të ndërtojmë dhe konsolidojmë progresin e arritur deri më sot.

Si rrjedhojë, mbi bazën parimit të të drejtave të barabarta Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Planit të dytë Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 paraqet një kornizë të radhës së veprimeve me masa konkrete të cilat do ta përmbushin edhe më tej misionin e Strategjisë dhe që sigurisht do të reflektojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve me aftësi të kufizuara për tri vitet në vazhdim.

Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 përbën një politikë nacionale e cila ngërthen nevojat e qytetarëve me aftësi të kufizuar dhe që si të tilla dallojnë për nga mosha dhe aftësia e kufizuar. Një i porsalindur me aftësi të kufizuar i cili ka nevojë për identifikim dhe intervenim të hershëm, një fëmijë me aftësi të kufizuar i cili ka nevojë për një integrim në shkollë, një i rritur për një punë të përshtatshme, shërbime gjithëpërfshirëse apo edhe për një përkrahje shtetërore e cila i siguron një mirëqenie dhe jetë të dinjitetshme. Pra, ky dokument është i hartuar duke dëgjuar zërin e personave me aftësi të kufizuara dhe si i tillë nuk anashkalon asnjë nevojë apo person me aftësi të kufizuar pavarësisht moshës, gjinisë apo llojit të aftësisë së kufizuar.

Për më tepër plani bënë thirrje për të gjithë akterët duke filluar nga individët, organizatat për personat me aftësi të kufizuara, institucionet dhe të gjithë qytetarët për zhvillimin e një shoqërie që vlerëson dhe respekton të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa dallim.

Si përfundim suksesi i këtij dokumenti do të reflektojë punën dhe angazhimin e çdo institucioni dhe gjithë Qeverisë së Republikës së Kosovës në promovimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse ku të gjithë personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e saj.

ANALIZA E TË ARRITURAVE TË PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2013-2015

Plani Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 është hartuar paralelisht me Strategjinë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Plani në kuadër të objektivave strategjike ka planifikuar përpjekjet e para në përmbushjen e misionit dhe vizionit të strategjisë.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në baza vjetore ka paraqitur të gjitha të arriturat dhe sfidat e zbatimit të këtij dokumenti. Në këtë kontekst janë publikuar edhe raporti i progresit për 2013-2014 dhe raporti i progresit për vitin 2015.

Fushat e intervenimit janë shtri në disa aspekte si: shëndetësi, mirëqenie sociale, punësim, arsim, mbrojtje ligjore dhe qasje në gjithëpërfshirje.

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara

Aprovimi i Ligjit për Sigurimet Shëndetësore Nr. 04/L -249 në këtë periudhë ka qenë një ndër hapat më të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, i cili i jep një dimension të ri për kujdesin shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara. Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i qasjes universale të qytetarëve ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor. Varfërimin për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor kryesisht e përbëjnë personat me aftësi të kufizuara dhe si të tillë nga momenti i fillimit të zbatimit të ligjit do të jenë të liruar nga pagesa e premiumeve.

Si vazhdim Ministra e Shëndetësisë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore ka finalizuar korrikulën e shkollimit specialistik ku është inkorporuar komponenta e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. Ndërsa ofrimi i shërbimeve shëndetësore ka avancuar gjithashtu me funksionalizimin e manualit për vizitat në shtëpi. Manualin kanë filluar ta përdorin infermierët të cilët realizojnë vizita në shtëpi që kanë për fokus kujdesin e nënave dhe foshnjave të posalindura, pra përmes këtij udhëzuesi infermierët i kushtojnë rëndësi edhe identifikimit të hershëm të problemeve në zhvillim të foshnjës.

Sigurimi i materialit për inkontinencë si dhe materialit për plagë dekubitare ka kontribuar edhe më tej në ofrimin e shërbimeve bazuar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Në anën tjetër sfidat të cilat do të na përcjellin edhe në vitet në vijim janë definimi i listës për pajisjet asistuese bazike shëndetësore për nevojat e PAK dhe sigurimi i tyre, përmbushja e listës esenciale bazuar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara, zbulimi i hershëm përmes laboratorit për diagnostifikim paranatal dhe së fundmi por jo më pak e rëndësishme funksionalizimi i njësisë për ofrimin e shërbimeve spinale në vend.

Objektiva Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Mbrojtja sociale dhe punësimi janë dy çështje me rëndësi në kuadër të Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, ku theksohen qartë obligimet e shtetit mbi njohjen dhe përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për një standard adekuat jetese, përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin, punësimin si dhe sigurimin e pensionit.

Që vizioni i kësaj objektivë të shkojë në drejtimin e duhur në kuadër të Planit të Veprimit për PAK 2013-2015 është arritur të fillojë shtrirjen e shërbimeve në komunitet si dhe të ndryshohet legjislacioni për krijimin ekushteve të barabarta për punësimin e PAK.

Në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në Ligjin 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, që nga fillimi i vitit 2013 ka filluar shtrirja e shërbimeve në komunitet. Ky proces fillimisht ka filluar me licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të nivelit superior, të lartë, të mesëm dhe bazik. Ndërsa për vitin 2015 ka vazhduar me licencimin e subjekteve Juridike/organizatave jo qeveritare të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Gjithashtu në këtë periudhë është ndërtuar dhe funksionalizuar edhe shtëpia e tetë (8) në komunitet për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit. Në këtë kontekst ka filluar edhe procesi i decentralizimit të shërbimeve rezidenciale në komunat përkatëse, përveç dy shtëpive të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilat do të vazhdojnë të mbesin nën menaxhimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ndryshim plotësimi i Ligjit nr.03/L-019, për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ka vendosur politika të cilat do të inkurajojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

Ndërsa me qëllim të aftësimit profesional të punëkërkesve me aftësi të kufizuara ka vazhduar puna në tetë Qendra të Aftësimeve Profesionale që gjenden në shtatë qendra regjionale të Republikës së Kosovës. Në Qendrat e Aftësimit Profesional të përshtatshme për PAK janë në dispozicion disa profesione si: kompjuter-Braille, përdorim i kompjuterit (TIK), administrim biznesi, floktari, furrtari, pastičeri dhe përpunim qumështi. Si rrjedhojë në vazhdimësi kanë qenë të përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sfiduse edhe për vitet e ardhshme do të jetë ofrimi i shërbimeve rehabilituese, ngritja e vlerës së përfitimit financiar për mirëqenien e Personave me Aftësi të Kufizuara në mënyrë që të përmbushin nevojat e plota për një jetë të dinjitetshme të përfituesve, si dhe sfida e radhës është krijimi i mekanizmave funksional për zbatimin e Ligjit për Aftësimin ,Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Objektiva Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara

E drejta për edukim është e drejtë elementare e çdo njeriu. Që kjo e drejtë të realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shteti duhet të sigurojë një sistem edukimi gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Në këtë kontekst Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kuadër të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 ka bërë përpjekje të vazhdueshme me qëllim që fëmijët me aftësi të kufizuara gjithnjë e më tepër të jenë pjesë e shkollave dhe klasave të rregullta.

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet është një dokument me rëndësi i cili siguron qasje gjithëpërfshirëse në edukimin hershëm ku në qendër është fëmija dhe arritjet e tij në periudha të caktuara të moshës dhe në fusha të ndryshme zhvillimi.

Standardet për shkollat mike për fëmijë, që mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlihd aspektet e reformës në arsim dhe e cila e vendos fëmijën në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve për fushën e arsimit gjithëpërfshirës janë punësuar 9 edukatorë mbështetës për nivelin parashkollor dhe 28 mësime mbështetës për shkolla të rregullta. Programi 3 vjeçar 2013-2015 për aftësimin e 17 asistentëve dhe inspektorëve të gjuhës së shenjave është një program tjetër i cili ka aftësuar personat e parë në Kosovë për përdorimin e gjuhës standarde të shenjave.

Gjithnjë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve një fokus i madh i është dhënë trajnimeve nga programe të ndryshme ku janë përfshirë 5400 pjesëmarrës, prej tyre zyrtarë të arsimit në nivelin komunal, drejtori të shkollave, mësimdhënës, prindër etj.

Hartimi i dokumenteve pedagogjike ka qenë një prej çështjeve po ashtu që i është kushtuar rëndësi gjatë kësaj periudhe meqë ka pasur mungesë të madhe të tyre dhe ajo që vlenë të përmendet është Plani Individual i Edukimit (PIA) përfshirë udhëzuesin dhe formularin i cili mund të përdoret nga mësimdhënësit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Në kuadër të kësaj janë zhvilluar shumë trajnime, por akoma kjo mbetet një sfidë për mësimdhënësit se si ta zbatojnë atë në praktikë. Adoptimi i udhëzuesit “Indeksi për gjithëpërfshirje” dhe pilotimi në 8 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe në 8 Institucione Parashkollore në 8 komuna ka qenë po ashtu një veprim tjetër i cili ju ka ndihmuar Institucioneve parashkollore dhe shkollave në krijimin e një ambienti më gjithëpërfshirës. Këto janë shkollat dhe Institucione parashkollore të para model në Kosovë. Për zbatimin e indeksit janë trajnuar rreth 500 mësimdhënës dhe drejtor të shkollave.

Një e arritur shumë e rëndësishme është edhe themelimi i ekipeve vlerësuese pedagogjike. Aktualisht 28 Komuna kanë caktuar zyrtarët për arsim gjithëpërfshirës ndërsa 13 Komuna kanë themeluar ekipet vlerësuese profesionale për fëmijët me aftësi të kufizuara. Si rrjedhojë është hartuar udhëzuesi dhe instrumenti për ekipet vlerësuese profesionale në komuna, me të cilën instrument ata bëjnë vlerësimin e fëmijëve/nxënësve.

Vetëdijesimi i komunitetit ka qenë një aspekt tjetër i cili ka pasur në fokus kryesisht komunitetin, shkollat dhe prindërit. Për këtë janë përgatitur dhe shpërnda broshura, fletëpalosje dhe janë organizuar fushata të ndryshme mediale të cilat kanë pasur si qëllim rritjen e vetëdijes së shoqërisë për rëndësinë e arsimit për personat me nevoja të veçanta .

Në anën tjetër implementimi i objektivës strategjike në sektorin e arsimit ka edhe shumë sfida, si: mungon adaptimi i programeve për ofrimin e edukimit në shtëpi dhe gjatë trajtimit shëndetësor, hartimi i standardeve për PAK për arsimim në nivel universitar, punësimi i mësuesve udhëtues, punësimi i mësimdhënësve mbështetës bazuar në nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, trajnimi i mësuesve udhëtues dhe i asistentëve personal, zhvillimi dhe zbatimi i programeve specifike për intervenimet e hershem si dhe përgatitjet për themelimin e qendrave për identifikim dhe intervenim të hershëm

Objektiva Strategjike 4: Krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Republika e Kosovës ka qenë në vazhdimësi e fokusuar në kompletimin e legjislacionit vendor në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Duke u bazuar në veprimet e planifikuara në kuadër të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 është arritur që të kemi dy ligje specifike mbi llojin e aftësisë së kufizuar, Ligjin për Personat e Verbër dhe Ligjin për Statusin e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji. Këto ligje kanë përcaktuar shumë aspekte si: jetesën e pavarur, asistentët personal, shkollimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Ligji për Personat e Verbër tashmë ka filluar të zbatohet, ku përfitojnë përkrahje financiare për efekte verbërie të gjithë personat e verbër, ndërsa personave të verbër të kategorisë së parë ju sigurohet edhe asistenti personal. Ndërsa për zbatimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji është marr vendimi i Qeverisë për shumën e kompensimit të qytetarëve me paraplegji dhe tetraplegji.

Miratimi i pakos së Ligjeve për të Drejta të Njeriut, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, Ligji

¹ Republika e Kosovës, Kuvendi (2015) Ligji nr. 05/1 -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, maj 2015

për Barazi Gjinore² dhe Ligji për Avokatin e Popullit³ ka qenë gjithashtu një avancim i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ku trajtohen disa aspekte me rëndësi për qytetarët me aftësi të kufizuara.

Ndryshim plotësimi i Ligjit nr.03/L-019, për Aftësimin, Riaftësim dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ka krijuar gjithashtu mekanizmat dhe politika të cilat do të inkurajojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

Nisma të tjera ka pasur edhe në hartimin dhe shqyrtimin e vazhdueshëm të shumë udhëzimeve dhe rregulloreve që prekin të drejtat e PAK, me theks të veçantë në fushën e edukimit, të cilat kanë plotësuar edhe më tej kornizën legislative për personat me aftësi të kufizuara.

Vetëdijësimi mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ka qenë gjithashtu një aspekt i cili ka pasur në fokus trajnimin e zyrtarëve në institucione korrektuese. Trajnime të cila do të vazhdojnë të mbahen edhe në shumë institucione të tjera dhe që do të reflektojnë në ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve dhe të vet institucioneve në trajtimin e drejtë të qytetarëve me aftësi të kufizuara.

Ndërsa sfiduese për vitet e ardhshme mbetet hartimi i ligjit për unifikimin e politikave sociale për personat me aftësi të kufizuara. Politikë e cila do të përcaktojë kategorizimin sipas shkallës së aftësisë së kufizuar, vlerësimin e aftësisë së kufizuar bazuar në standardet e klasifikimit ndërkombëtar të funksionalitetit⁴, përkrahjen financiare për një mirëqenie të të gjithë personave me aftësi të kufizuara si dhe sigurimin e shërbimeve bazuar në nevojat dhe shkallën e aftësisë së kufizuar.

Objektiva Strategjike 5: Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara

Bazuar në Planin Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2015 fokusi i objektivës dhe i të gjitha institucioneve të angazhuara për zbatimin e tij ka qenë mbështetja për kapërcimin e barrierave të tilla si paragjykimet, krijimi i një komunikimi i cili mbulon çështje të tilla si formatet e aksesueshme për persona të verbër dhe të shurdhër, sigurimi i qasjes fizike në ndërtesa dhe rrugë, si dhe integrimi i të gjithëve në aktivitete kulturore.

Me miratimin e Rregullores për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave, është arritur që nga muaji prill 2016 të jetësohet me sukses e drejta e qytetarëve të shurdhër për të marr shërbime në gjuhën e shenjave sipas nevojave të tyre në të gjitha institucionet publike në vend.

Ky vendim e ka pozicionuar Republikën e Kosovës në një ndër vendet e para në Evropën Juglindore që ka marrë këtë hap dhe që përbën një shembull pozitiv për vendet e rajonit dhe më tej.

Komunikimi nuk ka munguar edhe tek personat e verbër, ku në vazhdimësi janë realizuar publikime në shkrimin brail për të gjithë legjislacionin dhe dokumentet tjera me rëndësi për komunitetin e personave të verbër. Të arritura të tjera në këtë aspekt kanë qenë edhe sigurimi i kompjuterëve të qashtëm për personat me aftësi të kufizuara si dhe pajisja me Licenca Jaws për personat të cilët nuk e njohin alfabetin Brail.

Gjithsesi përmes përpjekjeve të institucioneve relevante në vazhdimësi është punuar edhe në sigurimin e qasjes për PAK në institucione shëndetësore dhe arsimore,⁵. Megjithatë zbatimi i

² Republika e Kosovës, Kuvendi (2015) Ligji Nr. 05 / L-020 për Barazinë Gjinore. Prishtinë, maj 2015.

³ Republika e Kosovës, Kuvendi (2015) Ligji Nr. 05 / L-019 mbi Avokatin e Popullit. Prishtinë, maj 2015

⁴ KNF i përket familjes së klasifikimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH. Synimi kryesor i përgjithshëm i klasifikimit është sigurimi i një gjuhe standarde të unifikuar dhe një informacioni për të përshkruar shëndetin dhe rastet e lidhur me të. Ai përcakton komponentët e shëndetit si dhe ata komponentë të shëndetit që lidhen me mirëqenien (të tilla si edukimi dhe puna).

⁵ Sipas hulumtimeve të realizuar, qasje të personave me aftësi të kufizuar plotësojnë 25% e institucioneve shëndetësore dhe 75% e institucioneve arsimore.

udhëzuesit për qasje për personat me aftësi të kufizuara për të gjitha institucionet publike vazhdon të mos respektohet dhe të jetë sfidë edhe për vitet në vazhdim.

Në aspektin kulturor dhe sportiv institucionet përgjegjëse kanë themeluar Komitetin Para Olimpik të Republikës së Kosovës mbi bazën e të cilit është krijuar edhe ombrella ku marrin pjesë të gjithë personat me Aftësi të Kufizuara. Ndërsa për tri vitet e kaluara është zhvilluar e gjithë skema e granateve për realizimin e aktiviteteve në fushën e kulturës, sportit dhe trashëgimisë kulturore të zbatuara nga shoqatat për personat me aftësi të kufizuara.

Sfiduese vazhdon të jetë mbledhja e të dhënave dhe krijimi i sistemit të integruar të të dhënave në pothuajse të gjitha fushat mbi bazën e të cilit do të planifikohen dhe realizohen politika të caktuara dhe për më tej do të krijonin një matës për çdo progres të arritur.

QËLLIMI I PLANIT NACIONAL PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2018-2020

Realizimi i të drejtave të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe i përmbushjes së prioriteteve të Strategjisë dhjetë vjeçare për Personat me Aftësi të Kufizuara është një proces i cili kërkon përpjekje të vazhdueshme nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe vetë shoqëria jonë.

Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 është plani i dytë në kuadër të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 në nivel vendi dhe që ka për qëllim të avancojë edhe më tej të drejtat e personave me aftësi të kufizuara deri në arritjen e synimit final për krijimin e një *shoqërie gjithëpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara realizojnë potencialin e plotë të tyre dhe jetojnë jetë të dinjitetshme si qytetarë të barabartë*.

Ky dokument është shumë i rëndësishëm sepse i adreson nevojat dhe prioritetet e të gjithë personave me aftësi të kufizuara pavarësisht moshës apo gjinisë dhe që në total përbëjnë 93,288 të popullatës në Republikën e Kosovës⁶. Pra, plani përfshinë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjate të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në baza të barabarta me të tjerët.⁷

Veprimet e përcaktuara në këtë dokument mbështesin zbatimin e masave që janë projektuar për të përmbushur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në pesë fusha prioritare të jetës së personave me aftësi të kufizuara, si: shëndetësi, mirëqenie sociale, punësim, arsim, mbrojtje ligjore dhe qasje gjithëpërfshirëse. Andaj me finalizimin e këtij dokumenti kemi kanalizuar objektivat specifike dhe aktivitetet konkrete për tri vitet në vazhdim në kuadër të objektivave strategjike të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023.

Çdo veprim i paraqitur në kuadër të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 është i vendosur me miratimin e institucioneve përgjegjëse për zbatim dhe mbi bazën e nevojave të paraqitura nga vetë shoqatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara.

Si përfundim Republika e Kosovës me Planin Nacional për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 ka për mision të jetësojë të gjitha veprimet e paraqitura në mënyrë që jeta e personave me aftësi të kufizuara të përmirësohet edhe më tej në vendin tonë, për më tepër do të ndërmarr të gjitha masat për ndërgjegjësimin e shoqërisë për personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e tyre, nevojat e tyre dhe sigurisht potencialin dhe kontributin tyre.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare.

⁷ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Neni 1

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është e mandatuara që të realizoj monitorimin e zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 dhe si rrjedhojë edhe të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020.

Në këtë kontekst Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bazuar në mandatin e saj, që nga miratimi i Strategjisë dhe Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vënë në fokus kryesor monitorimin dhe implementimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme në sektorin e Aftësisë së Kufizuar.

Politikat e monitorimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit sa i përket përmbushjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara janë të shtrira në nivele të ndryshme duke filluar nga bashkëpunimi i ngushtë me Ministrinë në nivel qendror, të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, në koordinim me agjencionet e pavarura, institucionet ndërkombëtare si dhe organizatat që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Gjithsesi, politikat e monitorimit arrijnë në një nivel të dëshiruar edhe përmes mekanizmave institucional të cilët koordinohen po nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe janë të shtrira në dy nivele: nivel të lartë hierarkik të udhëhequr nga zv. Kryeministri në përbërje të pesë zv. Ministrave, si dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara që merren kryesisht me orientimin e politikave të përgjithshme në sektorin e Aftësisë së Kufizuar, si dhe nivel operativ një komisioni i emëruar nga sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që përbëhet nga zyrtarë të ministrive të ndryshme dhe organizata të personave me aftësi të kufizuara.

Monitorimi dhe raportimi kundrejt Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 do të realizohet në baza vjetore për të vlerësuar të gjitha të arriturat dhe sfidat në përmbushjen e objektivave dhe veprimeve të parapara në këtë dokument. Raportet e paraqitura do të vlerësohen mbi bazën e indikatorëve matës dhe afatet kohore për zbatim.

Gjithsesi Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2018-2020 përcakton veprimet kryesore nën çdo objektivë specifike, të cilat identifikojnë gjithashtu edhe institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për implementimin e tyre. Kur një institucion është përgjegjës për implementimin e një aktiviteti, gjithashtu janë të identifikuar edhe institucionet tjera të cilat do të ndajnë përgjegjësin apo edhe ato që do të ndihmojnë në zbatimin e tyre e që në këtë rast janë kryesisht donatorët dhe partnerët e përhershëm, organizatat për personat me aftësi të kufizuara.

